

KOSOVO



**KOMITETI OLIMPIK I KOSOVËS
KOSOVA OLYMPIC COMMITTEE**

Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës, në mbështetje të Nenit 6, pika k të Statutit të Komitetit Olimpik të Kosovës, nxjerr:

RREGULLORE PËR SHPALLJEN E LAUREATËVE TË VITIT NË SPORT

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kriteret, kushtet dhe procedurën për shpalljen e laureatëve të vitit në sport në Republikën e Kosovës, për sportet olimpike, federata kombëtare e të cilit është anëtare në federatën ndërkombëtare të njohur nga KON, sporti i të cilës është në programin Olimpik, si dhe anëtar i Komitetit Olimpik të Kosovës. Poashtu Rregullorja përcakton llojet e çmimeve dhe shpërblimet për secilin çmim.

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Federatat Kombëtare të njohura nga Komiteti Olimpik i Kosovës.

Neni 3

Laureatët e vitit në sport

1. Komiteti Olimpik i Kosovës bënë shpalljen e laureatëve të vitit në sport, përmes këtyre çmimeve:

1.1. Sportisti i vitit;

1.2. Sportistja e vitit;

1.3. Kombëtarja e vitit e meshkujve;

1.4. Kombëtarja e vitit e femrave;

1.5. Trajneri i vitit;

1.6. Shpresa Olimpike tek meshkujt;

1.7. Shpresa Olimpike tek femrat;

1.8. Çmimi special; (ky çmim i ndahet sportistit, trajnerit, referit, delegatit, punëtorit sportiv, hulumtuesit në fushën e sportit, gazetarit sportiv ose mjekut sportiv, për arritje të veçantë brenda vitit, nëse ka të tillë).

2. Çmimet e themeluara në paragrafin 1 të këtij Neni ndahen çdo vit dhe ndarja bëhet në një ceremoni solemne të organizuar nga KOK në muajin Shkurt të vitit pasues.

Neni 4
Kriteret

1. Kriter për shpalljen e sportistit të vitit dhe sportistes së vitit janë rezultatet e arritura në këto gara:

- 1.1. Lojërat Olimpikë;
- 1.2. Kampionatet Botërore;
- 1.3. Lojërat Evropiane;
- 1.4. Kampionatet Evropiane;
- 1.5. Kupat botërore të nivelit kualifikues ku për bazë merret vetëm rezultati më i mirë i tij/sajë;
- 1.6. Lojërat Mesdhetare;
- 1.7. Kampionatet Ballkanike dhe
- 1.8. Kampionatet Kombëtare.

2. Kriter për shpalljen e Kombëtares së vitit për meshkuj dhe Kombëtares së vitit për femra janë rezultatet e arritura në këto gara:

- 2.1. Kampionati Botëror;
- 2.2. Kampionati Evropian;
- 2.3. Pjesëmarrje në kualifikime në Kampionatin Botëror dhe Evropian.

3. Kriter për shpalljen e trajnerit të vitit janë rezultatet e arritura të sportistëve, klubeve apo Kombëtareve në këto gara:

- 3.1. Lojërat Olimpikë;
- 3.2. Kampionatet Botërore;
- 3.3. Lojërat Evropiane;
- 3.4. Kampionatet Evropiane;
- 3.5. Kupat botërore të nivelit kualifikues ku për bazë merret vetëm rezultati më i mirë i tij;
- 3.6. Lojërat Mesdhetare;
- 3.7. Kampionatet Ballkanike;
- 3.8. Kampionatet Kombëtare;

4. Kriter për shpalljen e Shpresës Olimpikë tek meshkujt dhe Shpresës Olimpikë tek femrat janë rezultatet e arritura në këto gara.

- 4.1. Lojërat Olimpikë për të rinjë;
- 4.2. Kampionatet Botërore për të rinjë;
- 4.3. Lojërat Evropiane për të rinjë;

- 4.4. Kampionatet Evropiane për të rinjë;
- 4.5. Kupat botërore të nivelit kualifikues për të rinjë ku për bazë merret vetëm rezultati më i mirë i tij/sajë;
- 4.6. Lojërat Mesdhetare për të rinjë;
- 4.7. Kampionatet Ballkanike për të rinjë; dhe
- 4.8. Kampionatet Kombëtare për të rinjë.
5. Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushen nga laureatët e çmimeve në sport janë:
- 5.1. Sportisti / sportistja, trajneri, shpresa olimpike mashkull/femer, referi, punëtori sportiv, hulumtuesi në fushën e sportit, gazetari sportiv, mjeku sportiv duhet të jenë qytetarë të Republikës së Kosovës.
- 5.2. Sportisti/sportistja që ka mbush moshën 15 vjeqare deri ditën që i mbushë 21 vjet konsiderohet shpresë olimpike.
- 5.3. Sportistit/sportistes i llogariten të gjitha rezultatet e arritura deri në ditën kur i mbush 21 vjet.
6. Cikli për shpalljen e laureatëve të vitit në sport fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor të vitit përkatës.
7. Nëse gjatë vlersimit të jurisë pikët në ndonjërin kategori janë të barabarta, përparësi duhet të ketë medalja që ka nivelin më të lartë, ose nëse ska medalje vlen rezultati më i lartë.

Neni 5

Motivacioni i Çmimeve

1. Çmimi Sportisti i vitit i ndahet sportistit, i cili gjatë vitit përkatës ka treguar performancë të shkëlqyeshme, duke fituar medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit, ose duke u ranguar në pozitën nga 4-8 në garat e përmendura në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje.
2. Çmimi Sportistja e vitit i ndahet sportistes, e cila gjatë vitit përkatës ka treguar performancë të shkëlqyeshme, duke fituar medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit, ose duke u ranguar në pozitën nga 4-8 në garat e përmendura në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje.
3. Çmimi Kombëtarja e vitit e meshkujve i ndahet Kombëtares së meshkujve, e cila gjatë vitit përkatës ka fituar Kampionatin Botëror ose Kampionatin Evropian, apo ka treguar rezultat më të mirë në këto gara, si dhe ka treguar rezultat më të mirë gjatë pjesëmarrjes në ndonjërin nga gjyrot e kualifikimeve të Kampionatit Botëror ose Kampionatit Evropian.
4. Çmimi Kombëtarja e vitit e femrave i ndahet Kombëtares së femrave, e cila gjatë vitit përkatës ka fituar Kampionatin Botëror ose Kampionatin Evropian, apo ka treguar rezultat më të mirë në këto gara, si dhe ka treguar rezultat më të mirë gjatë pjesëmarrjes në ndonjërin nga gjyrot e kualifikimeve të Kampionatit Botëror ose Kampionatit Evropian.
5. Çmimi Trajner i vitit i ndahet trajnerit, i cili gjatë vitit përkatës me punën dhe performancën e tij ka ndikuar që sportisti i tij ka fituar medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit, ose të jetë ranguar në pozitën nga 4-8 në garat e përmendura në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje, si dhe Kombëtarja që ai e ka udhëhequr ka fituar Kampionatin Botëror ose Kampionatin Evropian, apo ka treguar rezultat më të

mirë në këto gara, si dhe gjatë pjesëmarrjes në ndonjërin nga gjirot e kualifikimeve të Kampionatit Botëror ose Kampionatit Evropian.

6. Çmimi Shpresa Olimpikë tek meshkujt i ndahet sportistit, i cili gjatë vitit përkatës ka treguar performancë të shkëlqyeshme, duke fituar medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit, ose duke u ranguar në pozitat nga 4-8 në garat e përmendura në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

7. Çmimi Shpresa Olimpikë tek femrat i ndahet sportistes, e cili gjatë vitit përkatës ka treguar performancë të shkëlqyeshme, duke fituar medalje të artë, të argjendtë ose të bronzit, ose duke u ranguar në pozitat nga 4-8 në garat e përmendura në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje.

8. Çmimi Special i ndahet sportistit, trajnerit, referit, delegatit, punëtorit sportiv, hulumtuesit në fushën e sportit, gazetarit sportiv ose mjekut sportiv, për arritje të veçantë brenda vitit, nëse ka të tillë (ky çmim mund të ju ndahet më së shumti dy personave nga të gjithë të nominuarit, nëse juria vlerëson se ka arritje të veçantë brenda vitit për të cilin ndahet çmimi).

Neni 6

Vendimi për çmimet

1. Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës çdo vit emëron Jurinë për shpalljen e laureatëve të vitit në sport.

2. Juria përbehet prej pesë anëtarëve, sipas kësaj përbërjeje:

2.1. Një anëtar nga Bordi Ekzekutiv i KOK-ut;

2.2. Dy anëtar ish sportistë eminent vendor (të emruar nga BE i KOK);

2.3. Dy anëtarë gazetarë sportiv (të propozuar nga shoqata e gazetarve);

2.4. Kryesues i jurisë duhet të jetë njëri nga dy ish sportistët eminent që janë anëtar të saj;

2.5. Kryesuesin e zgjedh juria me shumicën e votave;

3. Pas përfundimit të vlerësimit Juria i rekomandon BE të KOK-ut për marrje të vendimit.

4. BE i KOK-ut me shumicë të thjeshtë të votave vendosë si pranoj ose ti refuzoi rekomandimet e Jurisë.

3. Presidenti i KOK-ut nxjerr vendimin për shpalljen e laureatëve të vitit në sport, pas rekomandimit të Jurisë dhe në përputhje me vendimin e BE të KOK.

Neni 7

Poentimi

Për shpalljen e laureatëve të vitit në sport, Juria duhet të vendos sipas poentimit të përcaktuar në Shtocën I të kësaj Rregulloreje.

Neni 8

Certifikata e çmimeve

1. Çmimet vjetore të shpërblyerve përmbajnë një certifikatë të nënshkruar nga Presidenti i KOK-ut, një statuetë dhe një çek në vlerën monetare të përcaktuar si në Nenin 9 të kësaj Rregulloreje.

2. Certifikata duhet të përmbajë: emblemën e Komitetit Olimpik të Kosovës, emrin dhe mbiemrin e laureatit të çmimit, motivacionin, emrin e çmimit, numrin dhe datën e vendimit për dhënien e çmimit, titullin, emrin, mbiemrin, dhe nënshkrimin e autoritetit që e nënshkruan dhe vulën e KOK.

3. Certifikata duhet të shtypet në letër kualitative, me format A3.

Neni 9
Shpërblimi financiar

1. Çmimet vjetore për sport nga KOK shoqërohen edhe me shpërblim financiar.
2. Lartësinë e shpërblimit financiar për secilin çmim e përcakton Bordi Ekzekutiv i KOK-ut për çdo vit.

Neni 10
Procedura

1. Komiteti Olimpik i Kosovës çdo vit u dërgon shkresë Federatave Kombëtare, përmes të cilës kërkon nominimin për laureatët e vitit në sport për të gjitha çmimet nga një nominim.
2. Kërkesa për nominim duhet të dërgohet më së largu me datën 10 janar të vitit pasues dhe federatat duhet t'i përcjellin nominimet e tyre brenda 10 dite.
3. Federatat kanë të drejtë të nominojnë nga një laureat për secilin çmim, pra një sportist, një sportiste, një kombëtare të meshkujve, një kombëtare të femrave, një trajner, një shpresë olimpike mashkull dhe një shpresë olimpike femër, si dhe sportist, trajner, refer, delegat, punëtor sportiv, hulumtues në fushën e sportit, gazetar sportiv, mjek sportiv.
4. BE i KOK ka të drejtë të nominojë nëse e sheh të arsyeshme nga një laureat për secilin çmim, pra një sportist, një sportiste, një kombëtare të meshkujve, një kombëtare të femrave, një trajner, një shpresë olimpike mashkull dhe një shpresë olimpike femër si dhe sportist, trajner, refer, delegat, punëtor sportiv, hulumtues në fushën e sportit, gazetar sportiv, mjek sportiv.
5. Nominimi nga federatat përkatëse, duhet të bëhet përmes formularit për nominim e laureatit të vitit në sport, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregullorje si Shtojca II.
6. Juria duhet të vlerësojë aplikimet brenda 10 dite, nga dita e mbylljes së aplikimit.
7. Ceremonia e shpalljes së laureatëve të vitit në sport bëhet gjatë muajit Shkurt të vitit pasues, për nderë të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, më 17 Shkurt, por jo më herët ose më vonë se 10 ditë prej datës 17 Shkurt.

Neni 11
Zbatimi

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Federatat Kombëtare në Kosovë.

Neni 12
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Bordi Ekzekutiv i KOK.


Besim HASANI

President i Komitetit Olimpik të Kosovës

Prishtinë,

Data : 21 / 02 / 2017

SHTOJCA I

Poentimi sipas të arriturave në garat sportive

Nr	Emri I Garës	Vendi	Pikët	
1.	Lojërat Olimpike	I	2000	
2.	Lojërat Olimpike	II	1000	
3.	Lojërat Olimpike	III	600	
4.	Lojërat Olimpike	IV	400	
5.	Lojërat Olimpike	V	350	
6.	Lojërat Olimpike	VI	300	
7.	Lojërat Olimpike	VII	250	
8.	Lojërat Olimpike	VII	200	
9.	Kampionati Botëror	I	1000	
10.	Kampionati Botëror	II	600	
11.	Kampionati Botëror	III	450	
12.	Kampionati Botëror	IV	300	
13.	Kampionati Botëror	V	250	
14.	Kampionati Botëror	VI	200	
15.	Kampionati Botëror	VII	150	
16.	Kampionati Botëror	VIII	100	
17.	Lojërat Evropiane	I	650	
18.	Lojërat Evropiane	II	500	
19.	Lojërat Evropiane	III	300	
20.	Lojërat Evropiane	IV	200	
21.	Lojërat Evropiane	V	150	
22.	Lojërat Evropiane	VI	100	
23.	Lojërat Evropiane	VII	75	
24.	Lojërat Evropiane	VIII	50	
25.	Kampionatet Evropiane	I	600	
26.	Kampionatet Evropiane	II	450	
27.	Kampionatet Evropiane	III	300	
28.	Kampionatet Evropiane	IV	200	
29.	Kampionatet Evropiane	V	150	
30.	Kampionatet Evropiane	VI	100	
31.	Kampionatet Evropiane	VII	75	
32.	Kampionatet Evropiane	VIII	50	
33.	Kupat botërore të nivelit kualifikues ku për bazë merret vetëm rezultati më i mirë i tij/sajë	I	400	
34.	Kupat botërore të nivelit kualifikues ku për bazë merret vetëm rezultati më i mirë i tij/sajë	II	250	
35.	Kupat botërore të nivelit kualifikues ku për bazë	III	150	

	merret vetëm rezultati më i mirë i tij/sajë			
41.	Lojërat Mesdhetare	I	250	
42.	Lojërat Mesdhetare	II	150	
43.	Lojërat Mesdhetare	III	100	
49.	Kampionatet Ballkanike	I	100	
50.	Kampionatet Ballkanike	II	75	
51.	Kampionatet Ballkanike	III	50	
57.	Kampionatet Kombëtare	I	50	
58.	Kampionatet Kombëtare	II	30	
59.	Kampionatet Kombëtare	III	20	

Forma e nominimit për laureatët e vitit në sport

Emri i Federatës	
Emri dhe mbiemri i sportistit, sportistes, kombëtar, trajnerit, referit të nominuar	
Data e lindjes së kandidatit të nominuar / data e themelimit të klubit	
Gjinia	
Adresa e kandidatit të nominuar / kombëtar të nominuar	
Numri i tel, e-mail adresa e të nominuarit	
Lloji i çmimit për të cilin nominohet	
Lloji i çmimit të fituar në garat e përcaktuara në Nenin 4 të kësaj Rregulloreje	
Motivimi për nominim	
Emri i autoritetit që nënshkruan nominimin në emër të federatës	
Nënshkrimi	
Data dhe vendi	